



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1172 / prot.
1

Tiranë më 13.10.2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 6897 Prot., datë 28.09.2020 me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin "*Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare*", së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit, sugjerojmë që në fund të fjalisë së pikës 7 të projektvendimit të shtohet togfjalëshi: "*... dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*".

Gjithashtu, nga pikëpamja e teknikës legjislative dhe me qëllim unifikimin e terminologjisë me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", (në vijim "*ligji nr.9887/2008*"), sugjerojmë që pika 9 e projektvendimit të riformulohet si vijon: "*Procedura e mbledhjes së të dhënave nga dokumentet e arkivuara të gjendjes civile, kryhet sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*".

Në mënyrë që të realizohet informimi i subjekteve të të dhënave personale, sugjerojmë që në Shtojcën nr. 1 "*Formulari i vetëdeklarimit/vetëidentifikimit të individit, shtetasit shqiptarë që i përket një pakice kombëtare*", të parashikohet një informacion, sa i përket detyrimeve që burojnë nga zbatimi i nenit 7 dhe 18 të ligjit nr. 9887/2008, si vijon: "*Të dhënat personale dhe sensitive të mbledhura nëpërmjet këtij formulari përpunohen vetëm për qëllim të*

identifikimit të personit që i përket një pakice kombëtare. Në çdo rast subjekti i të dhënave gëzon të drejtën e aksesit dhe korrigjimit të të dhënave të tij.”

Së fundmi, duke qënë se dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e vendimit nga prefekti i qarkut për njohjen e përkatësisë së një personi si pakicë kombëtare si dhe vetë vendimi i parashikuar në Shtojcën 2 përmbajnë të dhëna personale, vlerësojmë të nevojshme përcaktimin e një afati kohor për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit përkatës, në përputhje me gërmën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të ligjit nr. 9887/2008, ose në të kundërt të vlerësohet nëse zbatohen afatet e legjislacionit për arkivimin e dokumenteve publike.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

